



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 273

Prishtinë, Dt. 30/01/2026

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji
Projektpropozimi	"Vlerësimi i ndotjes bakteriale dhe parametrave fiziko-kimikë të ujit në Liqenin e Batllavës: Qasje sezonale dhe përdorimi i indeksit WQI"
Kandidati	Behije Kryeziu
Mentori	Prof. Dr. Idriz Vehapi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 25.09.2025 Vendimi nr. 3487

PËRMBLEDHJE E PUNIMIT

Punimi i diplomës master i kandidates Behije Kryeziu trajton një çështje me rëndësi të veçantë për cilësinë e ujit, mjedisin dhe interesin publik. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i cilësisë së ujit të Liqenit të Batllavës në bazë të parametrave fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë gjatë tri stinëve të vitit: pranverë, verë dhe vjeshtë.

Mostrat e ujit janë marrë në gjashtë lokalitete, në dy nivele thellësie (sipërfaqe dhe 30 cm), duke përfshirë gjithsej 36 mostra. Parametrat fiziko-kimikë të analizuar përfshijnë temperaturën, pH-në, konduktivitetin elektrik, totalin e lëndëve të ngurta të tretura (TDS), oksigjenin e tretur dhe kripshmërinë. Ndërkohë, aspekti mikrobiologjik u fokusua në identifikimin e baktereve treguese të ndotjes fekale, si dhe në përcaktimin e numrit të njësive formuese të kolonive (CFU).

Vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së ujit u realizua përmes Indeksit të Cilësisë së Ujit (WQI), i cili tregoi

variacione sezonale dhe hapësinore në nivelin e ndotjes së ujit.

Kandidatja Behije Kryeziu e filloi punën e saj hulumtuese me realizimin e analizave mikrobiologjike, të cilat përfshinë përcaktimin e koliformeve totale, koliformeve fekale, baktereve heterotrofe, si dhe detektimin e baktereve patogjene, përfshirë Salmonella spp. dhe Shigella spp. Gjithashtu, në analizat laboratorike u përfshi edhe përcaktimi i aktinomiceteve, të cilat shërbejnë si tregues të rëndësishëm të cilësisë ekologjike të ujit.

MATERIALI DHE METODAT

Pjesa e materialeve dhe metodave përshkruan në mënyrë të detajuar hapat e ndjekur për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e mostrave të ujit. Janë përdorur metoda laboratorike të standardizuara, të cilat mundësojnë analizimin e mostrave të marra në stinë të ndryshme të vitit në Liqenin e Batllavës, si në aspektin fiziko-kimik, ashtu edhe në atë mikrobiologjik.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Diskutimi i punimit të diplomës master të kandidatës Behije Kryeziu përbën një pjesë thelbësore të këtij studimi, duke ofruar një analizë të thelluar të të dhënave eksperimentale dhe interpretimin shkencor të rezultateve të fituara. Ky hulumtim paraqet një vlerësim të integruar të cilësisë së ujit të Liqenit të Batllavës, bazuar në analizën e parametrave fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë, si dhe në përdorimin e Indeksit të Cilësisë së Ujit (WQI), duke marrë parasysh variacionet sezonale.

Rezultatet tregojnë se cilësia e ujit të liqenit karakterizohet nga një gjendje përgjithësisht e qëndrueshme, megjithëse vërehen ndryshime të dukshme ndërmjet stinëve, të cilat pasqyrojnë ndikimin e faktorëve klimatikë, hidrologjikë dhe proceseve natyrore në ekosistemin ujqor.

Analiza e parametrave fiziko-kimikë tregon se vlerat e temperaturës, pH-së, oksigjenit të tretur, konduktivitetit elektrik, kripshmërisë dhe TDS-së qëndrojnë kryesisht brenda kufijve të pranueshëm, duke krijuar kushte të favorshme për funksionimin ekologjik të liqenit. Ndryshimet sezonale të këtyre parametrave ndikojnë drejtpërdrejt në proceset e oksigjenimit, tretshmërinë e substancave dhe stabilitetin e ujit, duke reflektuar dinamika tipike të ekosistemeve liqenore.

Nga ana tjetër, parametrat bakteriologjikë shfaqin një ndjeshmëri më të lartë ndaj ndryshimeve sezonale.

Prania e koliformeve totale dhe fekale, si dhe e baktereve të gjinisë Salmonella dhe Shigella, tregon ndikimin e burimeve të ndotjes dhe transportin e mikroorganizmave përmes rrjedhjeve sipërfaqësore, veçanërisht gjatë periudhave me reshje të shtuara dhe përzierje më intensive të ujit të liqenit. Ndërkohë, bakteret heterotrofe dhe aktinomicetet pasqyrojnë aktivitetin biologjik dhe proceset e dekompozimit të materies organike, të cilat intensifikohen në kushte termike më të favorshme.

REKOMANDIMET

Bazuar në rezultatet e fituara janë propozuar disa rekomandime:

- Të forcohet monitorimi i rregullt sezonal i cilësisë së ujit në Liqenin e Batllavës, duke përfshirë parametrat fiziko-kimikë, bakteriologjikë dhe indeksin e cilësisë së ujit (WQI), për një vlerësim më të plotë të gjendjes mjedisore dhe sanitare të ujit;
- Të zgjerohet përdorimi i indikatorëve biologjikë dhe mikrobiologjikë si mjete mbështetëse në vlerësimin e ndotjes së ujit, veçanërisht për identifikimin e ndikimit të ndotjes me origjinë fekale dhe aktivitetit mikrobial në cilësinë e ujit;
- Të rregullohen dhe zhvillohen aktivitetet rekreative dhe përdorimet e tjera të liqenit, me qëllim parandalimin e presioneve shtesë mbi cilësinë mikrobiologjike dhe ekologjike të ujit;
- Të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit lokal mbi rëndësinë e mbrojtjes së cilësisë së ujit dhe ndikimin e aktiviteteve antropogjene në ndotjen e liqenit;
- Të zbatohet kontroll më i rreptë sanitar gjatë periudhave me rritje të ngarkesës bakteriale, veçanërisht pas reshjeve intensive;
- Të forcohen masat parandaluese për reduktimin e ndotjes fekale, përmes përmirësimit të sistemeve të kanalizimit dhe menaxhimit të ujërave të ndotura në zonat përreth.

VLERËSIMI I KOMISIONIT

Bazuar në analizën e dorëshkrimit të punimit të diplomës master të kandidatës Behije Kryeziu, komisioni profesional sjell këto vlerësime:

Kandidatja ka dorëzuar punimin e saj në formë të plotë dhe sipas kërkesave të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Rregullores për studime master.




Rezultatet eksperimentale janë trajtuar në mënyrë shkencore dhe me përpikëri, duke përmbushur standarde akademike të kërkuara. Ky aspekt demonstroi aftësinë e kandidatës për të kryer kërkime të mirëfillta shkencore dhe për të interpretuar të dhënat në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.

Kandidatja ka demonstruar një përvojë të shkëlqyeshme në aplikimin e metodave për analizimin e mostrave të ujit dhe analizimin e këtyre mostrave. Kjo tregon jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësinë për të zbatuar këto njohuri në praktikë, duke sjellë zgjidhje konkrete për problemet mjedisore.

Komisioni profesional vlerëson pozitivisht këtë dorëshkrim të punimit të masterit dhe propozon që kandidatës Behije Kryeziu, ky punim t'i aprovohet si bazë për arritjen e gradës shkencore Master i Shkencave të Biologjisë.

Prishtinë, 30/01/2026

Komisioni:

1. 
Prof. Kasum Letaj – kryetar;
2. 
Prof. Dr. Idriz Vehapi – anëtar;
3. 
Prof. Lulzim Millaku – anëtar.

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.